

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. D., nga fshati Zh. Komuna e Gj., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat Sh. P.nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrolle, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. nr.184/2016, të datës 12.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 27.10.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. D., nga i ati S. dhe nëna H., i lindur më datë ..., në fshatin Zh. Komuna e Gj. ku edhe tani jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, i punësuar ne ..., din shkrim dhe lexim ka të kryer shkollën e mesme drejtimi i ..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datë2016 rreth orës ..., në rrugën "... " e Gj., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur ne pronësi armën e zjarrtë edhe atë revole e llojit "...", me numër serik ..., e cila armë i gjendet dhe sekuestrohet nga pjesëtarët e Policisë se Kosovës

Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrolle, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 42, 51, 53, 69, 73, 114 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK-ës dhe neneve 365, dhe 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin B. D., me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilin dënim burgu i akuzuari nuk do ta vuaj nëse në periudhën kohore prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të revokohet,

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrit edhe atë revole e llojit "...", me numër serik ... cal. ...mm.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr.184/2016 të datës 12.08.2016, kundër të akuzuarit B. D. nga fshati Zh., Komuna e Gj.t, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritör sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Arben Kadriu në deklarin e tij shtoi se meqë i akuzuari e ka pranuar veprën penale sa i përket rrethanave që duhet vlerësuar gjatë matjes së dënimit i propozoi gjykatës që ti merr parasysht si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari në tërësi e ka pranuar veprën penale, se i njëjti është njeri familjar, është baba i ... fëmijëve është penduar për veprën penale. Ndërsa si rrethana rënduese është evidente edhe atë pësha e veprës penale dhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare B. D., avokat Sh. P. deklaroi se i mbrojturi im në tërësi e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, i njëjti nuk ka pasur dijeni se nuk është e lejueshme të mbahet një armë e tillë, është njeri familjar, mbajtës i vetëm i familjes, dhe se pranimin e ka bere në mënyrë vullnetare pa kurrfarë presioni. Prandaj duke pasur parasysht këto fakte i propozoi gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të merr parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të akuzuarit ti shqiptoi një dënim më të butë, pasi që konsideroi se i njëjti dënim do ta jep efektin e duhur juridik.

I akuzuari B. D., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe shtoi, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të këtij lloji, ngase jam njëri familjar dhe mbajtës i familjes, për të njëjtën armë unë kam pas dijeni se nuk duhet ta mbaj dhe se jam penduar për këtë veprim timin.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në veçanti vërtetimin mbi konfiskimin e armës se zjarrit me date2016, dëftesë mbi konfiskimin e pronës me date2016, foto dokumentacionit edhe artë 7 fotografi, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari B. D., në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit edhe atë revole e llojit "...", me numër serik ... cal. ...mm dhe e njëjta i është sekuestruar nga ana e policisë, me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1.të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara në nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se deri më tani është i pa gjykuar për vepër tjetër penale pra është hera e parë që ndeshet me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit të veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues me ç rast të akuzuarit S. L., i është konfiskuar arma e zjarrit edhe atë revole e llojit "...", me numër serik ... cal. ...mm, është bazuar në neneve 69 par.1 dhe 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 194/2016 Më datë 27.10.2016**

Sek. Juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.